



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES



MUNICIPALITY OF SHITE/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Nr.prot. 02/1102/1

Datë 22.09.2025

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me Organizata, Klube Sportive dhe Biznese, e mbajtur më 9 shtator (e martë) 2025, në ora 16:00, në Sallën e Kuvendit të Ndërtesës së Komunës

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes Dr. Qemajl Aliu, Nënkryetari Faruk Beqa, Kryesuesi Adnan Ademi, Shekfi Dauti (KF VJOSA), Labionot Jetishi (IVR), Besnik Ahmeti (DBF), Skender Dauti (KSH), Milaim Rushiti (AOK), Klesta Krasniqi (Roots Center) dhe Vlora Hyseni (ZI).

Kryetari Dr. Qemail Aliu: Mirë se erdhët në këtë mbledhje, dëgjim publik me përfaqësues të shoqërisë civile, të organizatave joqeveritare, rinore, kulturore dhe sportive, e cila organizohet në kuadër të buxhetit komunal 2025–2026. Jemi pikërisht në fazën e dytë të kornizës buxhetore, përkatësisht në draftimin e buxhetit, i cili në fund të shtatorit do të kalojë për miratim në Asamblenë Komunale dhe, siç e dini, për një vit të tërë qeverisja jonë komunale funksionon në bazë të këtij ligji-ligjit më të rëndësishëm vjetor: Ligjit të Buxhetit.

Kur kemi ardhur para katër vitesh, buxheti i Komunës së Shtimes ka qenë 7.8 milionë euro. Ndërsa buxheti që jemi duke e draftuar dhe presim të miratohet në shtator është 11,443,936 euro një rritje solide që vjen si rezultat i menaxhimit të mirë dhe performancës së lartë të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë Qendrore, e cila është reflektuar në ndarjen e grantit për komunat.

Këtu po shoh edhe një ish-asambleist që këto çështje i njeh shumë mirë Shefkijun. Besoj se si intelektualë dhe qytetarë të angazhuar, e kemi vëmendjen te zhvillimet publike dhe komunale, dhe

i njihni mirë këto procese. Sot jam bashkë me nënkryetarin Faruk Beqa, me kryesuesin Adnan Ademi, me drejtorin e financave Besnik Ahmeti, si dhe me kolegen tonë Vlora Hyseni, e cila udhëheq Zyrën për Komunikim dhe Media.

Buxheti ndahet në disa kategori: rreth 50% shkon për paga, pasi Komuna e Shtimes ka mbi 730 punëtorë në arsim, shëndetësi, administratë dhe shërbime publike. Mbi gjysmën e buxhetit e përbëjnë pagat, ndërsa mëditje nuk ka -të paktën jo për menaxhmentin politik apo kabinetin tim, ku prej ditës së parë nuk kemi lejuar të paguhet asnjë mëditje.

Investimet kapitale janë 2.5 milionë euro, mallrat dhe shërbimet 1.5 milionë, pagat dhe mëditjet 6.8 milionë, subvencionet 500,000 euro, ndërsa shpenzimet komunale 230,000 euro. Në total: 11,443,000 euro. Rritje ka pasur në të gjitha digasteret si rezultat i buxhetit qendror.

Siç dihet, buxheti i komunës ndahet në bazë të numrit të popullsisë, shtrirjes gjeografike dhe madhësisë sipërfaqësore. Për 24 mijë banorë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, Komunës së Shtimes i takon ky buxhet. Territori i komunës është mbi 131 km².

Sa i përket subvencioneve pasi jemi me shoqata dhe OJQ kjo kategori është ajo që mbështet financiarisht projektet dhe angazhimin tuaj. Ne i kemi gjetur rreth 230,000 euro subvencione dhe menjëherë kemi tentuar ta rrisim këtë shumë në maksimum, qoftë në arsim, kulturë, rini, sport apo bujqësi.

Ekziston një klauzolë që përcakton kufizime për përqindjen e buxhetit që mund të ndahet për subvencione. Edhe pse kemi dashur të ndajmë deri në 1 milion euro, nuk lejohet të tejkalohet 5% e shumës totale. Vjet kemi pasur rreth 10 milionë euro buxhet dhe, kur i mbrojmë këto kufij para analistëve të Ministrisë së Financave, duhet t'i arsyetojmë dhe justifikojmë mirë.

Ne e kemi çuar subvencionimin në kufirin maksimal prej 5% të buxhetit total. Për ta përkthyer në shifra: në vitin e parë kemi gjetur rreth 28- 29 mijë euro për sport, rini dhe kulturë, ndërsa tani ndajmë mbi 100,000 euro për këto kategori. Në bujqësi, nga 40 mijë euro kemi kaluar në mbi 120,000 euro. Nga 24 bursa që kemi gjetur, tani ndajmë 120 bursa.

E kemi dyfishuar shumën nga 240,000 euro që ka qenë atëherë, me synimin që asnjëherë të mos e ulim përqindjen maksimale prej 5%. Këtë e bëjmë me qëllim të mbështetjes së OJQ-ve, jetës sportive, kulturore dhe arsimore në Komunën e Shtimes. Edhe pse disa kolegë të mi më kanë thënë se

subvencionimi nuk quhet zhvillimor, pasi zhvillimi lidhet me investimet kapitale dhe mallrat e shërbimet, unë besoj ndryshe. Dikush ka qejf me “blu në dorë”, por unë jam prej atyre që ec bashkë me ekipën time, me filozofinë time jo të mbjelljes së misrit dhe grurit, por të arës që mbillet sot dhe korret pas tetë vitesh.

Ne konsiderojmë se subvencionimi i artit, kulturës, arsimit në këtë rast botimeve, studentëve, të rinjve dhe të rejave në sport e kulturë ka efekt afatgjatë, që shihet pas shumë vitesh. Prandaj, prioritetet tona janë shoqatat, rinia, kultura dhe arsimi, dhe këtë e dëshmojmë me shifra konkrete.

Jemi këtu bashkë me nënkryetarin, siç e përmenda, me kryesuesin dhe drejtorin e financave. Debati është i hapur. Para se të kalojmë te çështja e evidentimit të mbajtjes së procesverbalit nga kolegja Vlora, është mirë që secili pjesëmarrës të prezantohet dhe të tregojë çfarë përfaqëson.

Shefki Dauti - Klubi i Futbollit “Vjosa” Shtime: Përsëendetje për ju kryetar, nënkryetar, kryesues i Kuvendit, drejtor, zyrtarë dhe përfaqësues të organizatave dhe klubeve sportive. Para se të nisë debati, do të duhej të kishim parasysh që sidomos klubet që janë subvencionuar më mirë të ishin prezent, për të ditur çfarë ka ndodhur dhe rëndësinë e kësaj dite. Diskutimi sot është konkretisht për këto klube dhe organizata. Për secilin klub e keni edhe numrin e telefonit është mirë të kontaktohen, sepse është më direkte. Ky format diskutimi është i dobishëm, por nuk po shoh përfaqësues të mjaftueshëm, kur e dimë që ka goxha shumë klube sportive.

E thatë vetë: buxheti është rritur, dhe paralelisht është rritur edhe përkrahja për sportin, rininë dhe gjithë procesin që ka kaluar në Shtime. Kur flas për futbollin në Shtime, ata që janë në rrjedha e dinë që kemi kaluar një fazë të vështirë. Por, duke pasur parasysh që kryetari ka qenë mjaft insistues që klubi i futbollit “Vjosa” të vazhdojë me rezultatet pozitive që ka pasur, besoj se me pak vështirësi do të rregullohet situata.

Publikisht dua ta falënderoj për angazhimin në ndërtimin e infrastrukturës së stadiumit. Po ndërtohet një stadium modern që pritet të përfundojë brenda këtij viti. Secili klub që vjen, na ka lakmi për infrastrukturën që kemi. Për klubin tonë, kushtet janë maksimale dhe jemi falënderues.

Përveç subvencionimit, karshi rritjes së buxhetit janë rritur edhe shërbimet e tjera. Besoj se investimi më i nevojshëm dhe më i drejtpërdrejtë është në sport. Nuk është një investim që shihet menjëherë si një ndërtesë, por është i domosdoshëm për shoqërinë tonë, për angazhimin e të rinjve në sport, duke pasur parasysh rrjedhat e rinisë.

Në këtë buxhet duhet të kemi parasysh që, në kategorizimin e subvencioneve, të jepet maksimumi i mbështetjes. Jeta është rritur, vlera e sportit po ashtu, dhe është mjaft e vështirë të mbahet një klub. Prandaj, është e rëndësishme që të mbështeten dhe t'u qëndrohet afër klubeve financiarisht, për shkak të sfidave që kanë. Nuk kam çfarë të shtoj tjetër, veçse ju falënderoj dhe besoj që gjatë gjithë procesit do të jemi së bashku si në të mirë, ashtu edhe në të keq. Faleminderit.

Kryetari Dr. Qemajl Aliu: Faleminderit Shefkiut për vlerësimin. Është e vërtetë që janë mbi 30 klube sportive që subvencionohen direkt nga komuna, si dhe 15 shoqata dhe OJQ që financohen nga ne. Këtu bëhet prerja, vijë e qartë është vendi i duhur për të shprehur shqetësimet, sugjerimet dhe kritikën, sepse pas miratimit të buxhetit nuk ka kthim prapa.

Kjo është "biblioteka aktive" dhe vëmendja e qytetarit në komunë. Ne, si qeverisje, prej ditës së parë kemi qenë të hapur dhe kemi dhënë mundësi për aktivizëm qytetar, të cilin e kemi përfillur. Buxhetin e ndërtojmë mbi dy shtylla: e para janë zotimet që kemi dhënë para qytetarëve, por asnjëherë nuk jemi zotuar pa shkuar te secili vendbanim, te secila shoqatë, te secili komunitet ku kemi marrë prioritetet e tyre. Pothuajse gjysma e prioriteteve tona kanë buruar pikërisht nga baza nga qytetarët dhe udhëheqësit e shoqatave. Është e çuditshme që nuk janë inkurajuar më shumë, të paktën në vitin e katërt. Por ka disa arsye që shumë prej jush i dini. Viti i katërt është vit elektorale, dhe për hir të së vërtetës jemi në koalicion me një subjekt tjetër, i cili ka udhëhequr këtë dikaster. Kushedi si u ka dalë llogaria atyre. Megjithatë, mund të vazhdojmë. Ju falënderoj që jeni prezent.

Klesta Krasniqi (Roots Center): Përshëndetje. A ka mundësi të kemi një dokument ose një ekran ku paraqitet qartë se çfarë buxheti është ndarë për turizmin, agroturizmin dhe për shëndetësinë? Sepse, nga sa dëgjova deri tani, fokusi ka qenë kryesisht te sporti. Sa i përket sportit, dua të theksoj se që nga korriku kam insistuar për fushën e futbollit, ku fëmijët nuk kanë as rroba, as topa. Nuk e di si shpërndahet buxheti, por është fatkeqësi t'i çosh fëmijët për të ushtruar dhe ata të mos kenë mjete bazike. Ndërkohë, për turizmin dhe agroturizmin, do të doja të dëgjoj më shumë: si e parashikoni zhvillimin në këto fusha për katër vitet e ardhshme?

Kryetari Qemajl Aliu: Zonjë, faleminderit për pyetjen dhe për prezencën tuaj. Menaxhimi i financave publike në Kosovë dallon nga ai në vendet prej nga vini si Zvicra apo Shqipëria. Ne, si institucion lokal, subvencionojmë shoqatat, ekipet dhe klubet, por subvencionimi nuk mjafton për funksionimin e plotë të një klubi. Ai mund të mbulojë 20- 30% të nevojave, ndërsa pjesa tjetër

duhet të sigurohet nga burime të tjera financimi. Një nga burimet është kontributi i prindërve, si një formë takse, dhe tjetra është ligji për sponsorizimin, që u mundëson bizneseve të bëhen sponsorë të klubeve sportive. Në shtetet e tjera ka modele të ndryshme, por te ne ligji dhe menaxhimi i financave publike është i strukturuar në këtë formë.

Sa i përket turizmit dhe agroturizmit, mendoj se kemi qenë avangardë në krahasim me komunat e tjera pa folur për qeverisjet para nesh. Vetëm në këtë fushë janë duke u investuar mbi 6 milionë euro. Kur them mbi 6 milionë euro, përfshij:

- Rrugët që lidhin fshatrat e malësisë me qytetin
- Investimet në zonën e parë ekonomike (afër gjysmë milioni euro)
- Investimet në zonën e dytë ekonomike, që është në fazat e fundit të funksionalizimit
- Rrugët Topillë- Petrovë, Petrovë-Rancë, Rancë-Grejqec, Pjetërshticë-Dugë-Karaqicë, Pjetërshticë- Zborc- Godanc
- Rruga që lidh zonën ekonomike të Gllavicës me rrugën Shtime- Ferizaj (afër 1 milion euro)

Të gjitha këto investime e tejkalojnë shifrën prej 6 milionë euro dhe synojnë të hapin perspektivë për investitorët private, biznese familjare, hoteleri, agroturizëm, blegtori dhe fusha të tjera, si dhe aktivitete që lidhen me kulturën, ecjen në natyrë (hiking) dhe disiplina të tjera. Ne, si institucion lokal, i paraprijmë shtrirjes së infrastrukturës dhe krijimit të kushteve. Më pas, i takon sektorit privat të investojë aty ku sheh leverdi dhe perspektivë. Në këtë aspekt, mendoj se jemi ballëhapur dhe kemi shifra konkrete e rekorde. Më vonë, kur të hyjmë në muajin elektoral, do të prezantojmë një program të veçantë para qytetarëve, ku do të shpалosim vizionin tonë për zhvillimin e bizneseve dhe agroturizmit, pas investimeve në infrastrukturën bazë.

Milaim Rushiti (Astronomy Outreach of Kosovo): Përsëndetje për të gjithë kryetar, nënkryetar, kryesues i Kuvendit, drejtor dhe të gjithë të pranishmit. Pasi zonja e mëparshme kërkoi fletën me investime, edhe unë e mora dhe dua ta ndaj fjalimin tim në dy pjesë. Së pari, në lidhje me projektet që po shoh këtu janë dy që më prekin direkt. Po flas në emër të OJQ-së “Astronomy Outreach of Kosovo” dhe për rëndësinë që ka ky projekt për komunën tonë. Jam falënderues ndaj dy qeverive që i kanë dhënë komunës së Shtimes një epitë tjetër, përtej asaj që kemi njohur deri

më tani. Është fat për komunën që për një vit e vizitojnë rreth 12,000 nxënës nga e gjithë Kosova, por edhe nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut diçka që nuk ka ndodhur më herët. Ne i kemi çuar maturantët në Shqipëri, por Shqipëria nuk ka sjellë nxënës këtu. Për herë të parë në Republikën e Kosovës vijnë grupe nxënësish, si rasti i fundit me 50 nxënës nga një shkollë në Durrës që vizituan Kosovën në kuadër të një vizite shkencore. Besoj që ka vlejtur barra qeraja për investimin që është bërë në Shtime. Pa hyrë në detaje për sfidat e kaluara, dua të ndalem te dy projektet që kapin vlera të mira: asfaltimi i rrugës “Beqir Rushiti” nëse është fjala për rrugën që të çon te Observatori, atëherë ndoshta bëhet fjalë për riasfaltim, sepse ajo është e asfaltuar. Dhe projektimi i trotuarit nga shkolla deri te Observatori, si dhe parkingu kjo është mëse e domosdoshme. Jam falënderues nëse është projektu si duhet, sepse është rrezik nga autobusët dhe ka nevojë për parking, siç e pamë edhe gjatë eklipsit para dy ditësh, kur kishte shumë vizitorë.

Shuma prej 5,000 eurosh që është paraqitur këtu më duket e vogël për të mbuluar të dyja parkingun dhe trotuarin por shpresoj të jetë e mjaftueshme. Edhe pse përfshihen segmente të tjera, kjo është ajo që më intereson mua. Pasi është hera e parë që po prezantoj në një mbledhje të Kuvendit për planifikimin e buxhetit, nuk e di ku kategorizohemi si OJQ te sporti apo te kultura. Sa herë që hapen thirrjet publike për subvencionim, nuk e di në cilën pjesë të aplikoj. Observatori duhet të mirëmbahen dhe të funksionalizohet siç i ka hije një qendre shkencore. Na duhet përkrahje institucionale. Deri tani kemi funksionuar me marrëveshje, por për të qenë institucion publik afatgjatë, propozoj që të bisedohet me Ministrinë e Arsimit për ta bërë Observatorin institucion publik, me një marrëveshje që garanton buxhet të rregullt. Përndryshe, funksionimi është i vështirë, pasi të hyrat nuk mjaftojnë dhe kemi probleme me financat, punëtorët dhe funksionimin e përgjithshëm. Kërkoj një trajtim më të veçantë për këtë OJQ, sepse është e para jo vetëm në Kosovë, por edhe në trojet shqiptare. Duhet një përkrahje më e veçantë. Ju faleminderit!

Kryetari Dr. Qemajl Aliu: Profesor, unë mendoj që ju nuk jeni as sport e as kulturë sepse shkenca është më shumë arsim dhe edukim. Ne kemi filluar kështu si kemi filluar, por rrugës do të gjejmë modalitetin më të mirë për t’i siguruar Observatorit stabilitet, mirëfunksionim dhe zhvillim. Ai nuk duhet të mbetet në stadin aktual, por të ripërtihet. Siç kemi folur edhe bashkë, do të përpiqemi që buxhetin ta bëjmë në mënyrën më të mirë që ky institucion jo vetëm të vazhdojë, por edhe të zhvillohet. Këto kanë qenë mundësitë tona për fillim nuk është keq por kjo nuk do të thotë që nuk do të investojmë më tutje në parking, trotuar dhe nevoja të tjera.

Pse jo, edhe të kategorizohet si institucion arsimor i veçantë në kuadër të ministrisë kjo do të ishte ideale. Jemi të hapur për diskutim dhe për të gjetur një modalitet juridik dhe status që e definojnë këtë çështje. Deri më tani ka ecur mirë falë angazhimit, përkushtimit dhe durimit tuaj, si dhe punës sonë të përbashkët.

Labinot Jetishi (Iniciativa Rinore - IVR): Përhëndetje. Jam pjesëmarrës në shumë aktivitete të mëparshme dhe përfaqësoj organizatën “Iniciativa Rinore” në Shtime. Dua t’ju përgëzoj për këtë organizim. Më herët nuk kam qenë shumë aktiv, por kam vërejtur që kohët e fundit ndarja e buxhetit po bëhet bashkërisht dhe nuk është si më herët, kur kishte seleksionime të organizatave në qeverisjen e kaluar. E përgëzoj kryetarin për hapjen ndaj qytetarëve dhe organizatave. E çmoj shumë që jam pjesë e kësaj mbledhjeje ku po bëhet ndarja e buxhetit.

Kryetari Dr. Qemajl Aliu: Faleminderit Labinot për vlerësimin dhe komentet. Jemi munduar të jemi transparentë dhe më vjen keq që në të kaluarën ka pasur seleksionime partiake dhe influenca të ngushta. Kam dëgjuar për aktivitetet e organizatës suaj dhe faleminderit që je rikthyer në shoqërinë civile për të dhënë kontributin tënd. Patjetër që do ta keni mbështetjen tonë, ashtu siç e kanë edhe organizatat e tjera.

Nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar, ju falënderoj për pjesëmarrjen.

Mbledhja ka përfunduar në ora 17:10






Procesmbajtës:

Vlora Hyseni



**Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin buxhetor me Organizata, Klube Sportive
dhe Bizneset**

Shtime, 9 shtator 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	KRASNIQI Kleska	Tshati Dugë Roots Center	
2	MILAIM RASHITI	ASTRONOMY OUTREACH OF KOSOVO	
3	SHEFKI DAUTI	KF VJOSA	
4	Arbender Dauti	K. K. Shtime	
5	Labinot Jefishi	-IVR-	
6	BESNIK AHMETI	K. K. SHTIME	
7	Adnan Alemi	K. K. Shtime	
8	FARUK BEGA	K. K. SHTIME	
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			

